
KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë **11.04.2022**, bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" - i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe statutin e shoqërisë "**INTER MEDIA GROUP**" SHPK, nënshkruhet kjo "kontratë për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

DISPOZITA PARAPRAKE:

- a. Shoqëria "INTER MEDIA GROUP" SHPK është një shoqëri tregtare me aktivitet në fushën e transmetimeve televizive, prodhimin, transmetimin dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji nëpërmjet audios, videos etj;
- b. Më datë 12.10.2018, "INTER MEDIA GROUP" SHPK (ish - Media Group In SHPK) ka nënshkruar një marrëveshje franchising me kompaninë EURONEWS S.A (Nr. Regj. Tregtar 387 858 046 - Lion, Francë), si rezultat i së cilës, ndër të tjera, ka përfituar të drejtën/licencën ekskluzive për të përshtatur, transmetuar dhe shpërndarë në gjuhën Shqipe, shërbimet e EURONEWS në territorin e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Kjo marrëveshje është nënshkruar për një kohëzgjatje fillestare 8 vjeçare me të drejtë ripërtëritje;
- c. Përshtatja, transmetimi dhe shpërndarja e shërbimeve të EURONEWS, në referencë edhe të marrëveshjes franchising të sipërcituar, po realizohet aktualisht në R.SH, nëpërmjet kompanisë së kontrolluar 100% nga INTER MEDIA GROUP SHPK, shoqërisë "EURO BALKANS NEWS" SHPK (NUIS L82305012L) e cila zotëron edhe licencën (TV) dhe autorizimet e nevojshme administrative të lëshuara nga autoritetet kompetente Shqiptare në lidhje me transmetimet audio-vizive në Shqipëri;
- d. Z. Theodor Çami në cilësinë e Ortakut të Vetëm të INTER MEDIA GROUP SHPK, është i interesuar të transferojë nëpërmjet shitjes **60%** të kapitalit të shoqërisë, tek shoqëria "KASTRATI" SHA, e cila nga ana tjetër është e interesuar të blejë kapitalin e sipërcituar;
- e. Për sa më sipër, palët bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë për shitje kuotash si vijon.



Neni 1

Palët kontraktuese

- 1) **Z. Theodhoro Çami**, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastrë, më datë 06.09.1981, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nga letërnjoftimi me numër I10906013F, nga këtu e më poshtë referuar si **"Shitësi"**.

dhe

- 2) Shoqëria **"KASTRATI" SHA**, me NUIS L92221506G, nga këtu e më poshtë referuar si **"Blerësi"**, përfaqësuar nga Administratorja **Znj. Eda Spahiu**.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitja prej Shitësit kundrejt Blerësit të **60% (gjashtëdhjetë përqind)** të kapitalit të shoqërisë "INTER MEDIA GROUP" SHPK (NUIS L61429018R).

Neni 3

Çmimi i shitjes

Çmimi i shitjes që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi, është **EUR 2,371,000 (dy milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë Euro)**.

Neni 4

Mënyra e pagesës dhe kalimi i pronësisë

4.1. Çmimi i shitjes i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, do të paguhet prej Blerësit brenda një afati kohor 3 (tre) mujor nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

4.2. Pagesat nga Blerësi do të realizohen duke kredituar llogarinë bankare të shoqërisë INTER MEDIA GROUP SHPK, si më poshtë vijon:

- Emri i llogarisë: INTER MEDIA GROUP SHPK
- Banka: ALPHA BANK
- Iban: AL11902112850281230021364245

Shoqëria "INTER MEDIA GROUP" SHPK, pasi të mbajë në burim dhe paguajë tatimin përkatës mbi shitjen e kuotave për llogari të Shitësit, do të transferojë menjëherë në llogarinë bankare të Shitësit, shumën që përfaqëson çmimin për shitjen e kuotave, pas pagesës së tatimit përkatës.

4.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Blerësi shndërrohet në pronar me të drejta të plota të një kuote që përfaqëson **60%** të kapitalit të shoqërisë "INTER MEDIA GROUP" SHPK, ose



e shprehur në vlerë 18.683.100 Lekë (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind lekë).

4.4. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pjesëmarrja në kuotat e kapitalit të shoqërisë "INTER MEDIA GROUP" SHPK do të jetë si vijon:

- i. Ortaku shoqëria "KASTRATI" SHA do të zotërojë **1 (një) kuotë** që përfaqëson **60% të kapitalit**, ose e shprehur në vlerë **18.683.100 Lekë**;
- ii. Ortaku **Theodhoro Çami** do të zotërojë **1 (një) kuotë** që përfaqëson **40% të kapitalit**, ose e shprehur në vlerë **12.455.400 lekë**;

Neni 5

Detyrimet e shitësit

5.1. Shitësi garanton se kuota objekt i kësaj kontrate, nuk është lënë peng, në dorëzani apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi të.

5.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën (kapitalin) objekt të kësaj kontrate, kuotë (kapital) që menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon Blerësit.

Neni 6

Detyrimet e Blerësit

Blerësi merr përsipër të paguajë çmimin e shitjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Neni 7

Të ndryshme

7.1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, palët bien dakord që çdo fitim i mundshëm (dividend) i realizuar nga shoqëria "INTER MEDIA GROUP" SHPK përgjatë vitit 2021, do t'i përkasë vetëm dhe ekskluzivisht ortakut Shitës në këtë kontratë.

7.2. I njëjti rregull si më sipër (neni 7.1) do të aplikohet edhe për të ardhura të tjera të mundshme që INTER MEDIA GROUP SHPK mund të përfitojë në të ardhmen nga shoqëri grupi apo persona të lidhur me shoqëri grupi. Për të evituar çdo paqartësi, në çdo rast ky aplikim vlen për të ardhura që burojnë nga transaksione/marrëveshje të nënshkruara përpara datës së kësaj kontrate. Shoqëri grupi për efekte të zbatimit të këtij neni do të konsiderohen shoqëritë e mëposhtme:



-
- i. "Data Centrum" SHPK - NUIS K81520004G;
 - ii. "Euro Academy News" SHPK - NUIS M12108031U;
 - iii. "Inter Active Media" SHPK - NUIS M02303008M;
 - iv. "La Strada" SHPK - NUIS K91511005Q;
 - v. "Tok Media" - NUIS K82430007K;

Neni 8

Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

- 8.1. Kjo kontratë përgatitet në 2 kopje, të dyja të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.
- 8.2. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

Z. Theodhoro Çami

[emër, mbiemër, firmë]

BLERËSI

"KASTRATI" SHA

Eda Spahiu

[emër, mbiemër, firmë, marta Shogener]

